



VALVOLAT SANWITCH CETOP

VALVOLAT E RREGULLIMIT TE PRURJES PER MONTIM NE PLLAKE, CETOP.....HK QV

Cilësitë	
Dizenjo	HK QV 06 - me kontroll direkt
Presioni maksimal	max. 250 bar
Lidhjet	ISO/Cetop 03 NG6 (vetëm A + B)
Montimi	Me 4 bulona me kokë fole heksagonale M5 x 70 12,9

Shënim	
Prurja mbahet konstante nëpërmjet balancimit të presionit	
Vlerat e prurjes regjistrohen me anë të manopolës së valvolës	
Kjo valvol ka të integruar edhe një valvol mos-kthimi me by-pass në drejtimin e kundërt të rrjedhjes	



HANSA FLEX

Kodi	Lidhjet	Vlera maksimale e prurjes (l/min)	Vlera minimale e prurjes (l/min)	Prurja maksimale në kthim B→A (l/min)	Diferenca e presionit Δp (Bar)	Versioni	Pesha (kg)
HK QV 06 1	ISO/Cetop 03-2 NG6	1.5	0.1	24	3	2-porta	1.200
HK QV 06 6	ISO/Cetop 03-2 NG6	6.0	0.1	24	3	2-porta	1.200
HK QV 06 11	ISO/Cetop 03-2 NG6	11.0	0.1	24	5	2-porta	1.200
HK QV 06 16	ISO/Cetop 03-2 NG6	16.0	0.1	24	7	2-porta	1.200
HK QV 06 24	ISO/Cetop 03-2 NG6	24.0	0.1	24	8	2-porta	1.200

Shënim	
Δp = është minimumi i diferencës së presionit që të realizohet funksioni i rregullimit të prurjes	
Për më shumë informacion ju lutemi shihni në adresën: https://cat.hansa-flex.com/docs/212591.pdf	

Aksesoret për këto valvola	
HK BHQ	Pllaka për montimin e valvolës së QV
HK BA QV	Pllaka për montimin e valvolës së QV
HK DHQ	Njësi për qarkullim të shpejtë dhe të ngadaltë për valvolën e rregullimit të prurjes, tip QV
HK M	Set i bulonave me përmasë metrike




PLLAKE LIDHESE PER VALVOLEN E RREGULLIMIT TE PRURJES TIP QV.....HK BHQ

Cilësitë

Furnizohet	Së bashku me set-in e bulonave
Presioni maksimal	max. 250 bar
Lidhjet	ISO/Cetop 03 NG6

Përshkrim

Kjo pllakë bën të mundur instalimin modular të valvolës HK QV 06 si një pllakë e ndërmjetme ISO/Cetop 03 NG6



Kodi	Vepron në kanal	Versioni	Pesha (kg)
HK BHQ 011	P	pa kapak, me vrima të hapura në një anë	0.700
HK BHQ 012	A + B	pa kapak	0.700
HK BHQ 013	A	me kapak	0.700
HK BHQ 014	B	me kapak	0.700
HK BHQ 016	T	pa kapak, me vrima të hapura në një anë	0.700
HK BHQ 022	A + B	pa kapak	0.700
HK BHQ 023	A	me kapak	0.700
HK BHQ 024	B	me kapak	0.700

Aksesoret për këto valvola

HK QV	Valvol për regullimin e prurjes për montim në pllaka CETOP
-------	--



EMC Engineering, Maintenance Center

Nje nder ligjet themelore te hidraulikes eshte " Vaji nën presion zgjedh rrugën ku has rezistencë më të vogël"

Duke ditur kete fakt, ju mund te llogjikoni qe kur mjeti nuk ka e duhur, atehere nuk mund te arrini direkt ne konkluzionin qe fajin e ka

Nese jeni i motivuar dhe deshironi ne te vertete qe te beheni specialist i hidromekanikes, EMC shpk disponon materialet e duhura, njerezit e duhur dhe durimin e duhur per t'ju trajnuar.

Ne duam te krijojme nje bashkepunim afatgjate me ju, pavaresisht se mund te jeni punonjes i nje kompanie tjeter.




EMC Engineering, Maintenance Center

Po të shihni tek kjo figurë, shtaga e cilindrit hidraulik është e lidhur me një ngarkesë e cila kryen lëvizje rrethore pasi është çernieruar. Në momentin kur nga pompa furnizohet vaj linjën e dhomës së shtagës së cilindrit, atëherë ngarkesa fillon të rrotullohet në sens antiorar. Kur ngarkesa arrin në pozicionin vertikal, atëherë forca që duhet për të vazhduar më tej lëvizjen, bëhet zero. Pas këtij momenti, sapo ngarkesa të marrë pak anë majtas, është vetë forca e rëndësës që e detyron shtagën e cilindrit të mbyllet. Në këtë moment pompa nuk është e aftë të furnizojë menjëherë aq vaj sa nevojitet në dhomën e cilindrit, ndaj direkt krijohet presion negativ (vakum).


Nese ne cilindër krijohet vakum, atehere, kjo sjell nje sere pasojash negative. Keshtu, nese guarnicionet e shtages jane te konsumuara, atehere nepermjet tyre hyn:

- nje sasi jo e vogel e grimcave te ngurta qe gjenden ne pluhurin qe rrethon ambientin e makinerise, duke ndotur vajin hidraulik,
- ajer i cili ben qe te lind fenomeni i kavitacionit,
- uje i cili perzihet me vajin hidraulik, duke i ulur dukshem atij cilesite lubrifikuese dhe cilesite e transmetimit te fuqise hidraulike



NJESI PER RRJEDHJEN E SHPEJTE DHE TE NGADALTE TE VAJIT NE VALVOLEN HK QV.....HK DHQ

Cilësitë	Valvol Sandwich
Dizenjo	Funksionon si njësi për rrjedhjen e shpejtë ose të ngadaltë të vajit hidraulik kur është e shoqëruar me valvolën e rregullimit të prurjes tip HK QV
Furnizohet	Së bashku me bobinën 24 VDC
Presioni maksimal	max. 250 bar
Lidhjet	ISO/Cetop 03 NG6
Montimi	Me 4 bulona me kokë-fole heksagonale M5 x 30 12,9 të gjatë



Përshkrim

Njësia për rrjedhjen e shpejtë dhe të ngadaltë të vajit hidraulik përbëhet prej valvolës HK DHQ dhe valvolës HK QV 06. Kur vaji qarkullon nëpërmjet valvolës HK DHQ, ai anashkalon valvolën HK QV 06 dhe për këtë motiv qarkullon shpejt. Në rastet kur vaji qarkullon nëpërmjet valvolës HK QV 06, me ane të kompensimit të presionit vaji qarkullon me shpejtesi të kontrolluar.

Kontrolli i prurjes së vajit realizohet kur selenoidi është i aktivizuar (pra kur tek bobina e selenoidit shkon rrymë elektrike)

Maksimumi i prurjes që kalon nëpërmjet valvolës së mos-kthimit është 24 l/min

Maksimumi i prurjes në gjendje të lirë është 36 l/min

Lartësia e pllakës është = 60 mm

Përshkrim

Prurja maksimale që kontrollohet varet nga lloji i valvolës që përdoret.

HK QV 06 1: 1.5 l/min

HK QV 06 6: 6 l/min

HK QV 06 11: 11 l/min

HK QV 06 16: 16 l/min

HK QV 06 24: 24 l/min

Kodi	Vepron në kanal	Versioni	Pesha (kg)
HK DHQ 011 OI 24DC	P	Kontroll në hyrje	2.500
HK DHQ 023 OI 24DC	A	Kontroll në hyrje	2.500
HK DHQ 024 OI 24DC	B	Kontroll në hyrje	2.500
HK DHQ 013 OI 24DC	A	Kontroll me drenazhim	2.500
HK DHQ 014 OI 24DC	B	Kontroll me drenazhim	2.500
HK DHQ 016 OI 24DC	T	Kontroll me drenazhim	2.500

Shënim

Për të parë grafikët dhe përmasat e valvolës Ju lutemi shihni në adresën <https://cat.hansa-flex.com/docs/212492.pdf>



EMC Engineering, Maintenance Center

I nderuar pergjegjes i mirembajtjes!

I nderuar Inxhinjer i mirembajtjes!

I nderuar teknik i mirembajtjes!

Nese ju do te njiheni me 132 gabimet qe behen ne mbare boten ne lidhje me sistemet hidraulike, ju do te filloni t'a shihni ndryshe veprimtarine Tuaj.

Kompania ju ka pranuar ne gjirin e saj sepse beson ne aftesite dhe njohurite tuaja.


Pronari i kompanise nuk eshte mirembajtjes, Administratori i kompanise nuk eshte mirembajtjes, as Inxhinjeri apo punonjesi i prodhimit nuk eshte mirembajtjes. Ndaj ata i fryne interesit te tyre. Ju jeni pajtuar per te qene mirembajtjes. Interes Juaj eshte performanca e larte e impianteve, makinerive dhe pajisjeve.

Nese ato jane te padisponueshme, Ju do te jeni objekti i sulmit. Prandaj nese ju keni njohuri te mira, ju do te jeni ne gjendje te kryeni dhe te mbron punen Tuaj.

PLLAKA PER MONTIMIN E VALVOLES TIP HK QV.....HK BA QV

Cilësitë	
Materiali	Çelik
Presioni maksimal	max. 350 bar
Lidhjet	ISO/Cetop 06-2 NG10


HANSA FLEX



Kodi	Lidhjet	Për valvol tip	Stacioni	Lartësia (mm)	Gjatësia (mm)	Gjerësia (mm)	Pesha (kg)
HK BA 302 Q	A+B 1/2" poshtë; P+T të mbyllura	HK QV 06	Me 1 lidhje	53	112	80	1.800
HK BA 322	A+P+T 1/2" poshtë	HK QV 10 3	Me 1 lidhje	35	140	106	4.200
HK BA 520	A+B 1" poshtë	HK QV 20 2	Me 1 lidhje	45	180	130	5.500
HK BA 522	A+P+T 1" poshtë	HK QV 20 3	Me 1 lidhje	45	180	130	5.500

VALVOL MOS-KTHIMI PER T'U MONTUAR NE PLLAKE CETOP.....HK AGRL

Cilësitë	
Dizenjo	Aktivizim me pilotim
Materiali	Çelik
Presioni maksimal	max. 315 bar
Prurja	Max. 500 l/min
Lidhja	ISO/Cetop P
Montimi	Me bulona HKM1045 për valvolën HKAGRL 10 / 20
	Me bulona HKM10100 për valvolën HKAGRL 32




Kodi	Prurja maksimale (l/min)	Raporti i kontrollit për presionin e pilotimit	Versioni	Pesha (kg)
HK AGRL 10	160	2.5	ISO/Cetop 06P	4.000
HK AGRL 20	300	2.1	ISO/Cetop 08P	7.000
HK AGRL 32	500	2.55	ISO/Cetop 10P	14.800

HANSA FLEX

Cilësitë	
Materiali	Çelik
Presioni maksimal	max. 350 bar
Lidhjet	ISO/Cetop 06-2 NG10

HANSA FLEX



Kodi	Lidhjet	Për valvol tip	Stacioni	Lartësia (mm)	Gjatësia (mm)	Gjerësia (mm)	Pesha (kg)
HK BA 305	A+B 1/2" poshtë; X+Y 1/4" poshtë	HK AGL 10	Me 1 lidhje	30	113	90	1.000
HK BA 505	A+B 1" poshtë; X+Y 1/4" poshtë	HK AGL 20	Me 1 lidhje	42	133	103	2.000
HK BA 705 A	A+B 1.1/2" poshtë; X+Y 1/4" poshtë	HK AGL 32	Me 1 lidhje	60	184	121	7.500



EMC Engineering, Maintenance Center

Nje nga detyrat me te rendesishme ne procesin e mirembajtjes se aseteve eshte identifikimi i materialeve te nevojshme.

Ne boten e hidraulikes, sasia e materialeve qe nevojiten eshte jashtezakonisht e madhe, ndaj dhe duhet te dish te orientoheshper gjetjen e produktit me te mire. Nga ana tjeter, edhe numri i furnitoreve te materialeve hidraulike eshte goxha i madh. Padyshim qe edhe cilesite e komponenteve qe ofrohen jane te ndryshme, çmimet gjithasht.

Pra si do veprojme?

Ne ne EMC shpk jemi ekspert per identifikimin e komponenteve te duhur.

Te mos flasim pastaj per nje nder problemet me te medha qe ndodh rendomt neper kompanite e vendit tone, POROSITE GABIM. Po ju tregoj nje histori:

Ne ofçinen tone erdhi nje klient i perhershëm i cili solli nje eskavator te markes CASE 590 SLE. E pyetem operatorin per defektet qe ai kishte evidentuar. Ai na referoi:

- kova e pasme nuk hapet;
- kova e perparme, hapet vete, ne menyre te pakontrolluar, kur e ngreme per te mbushur nje kamion,
- mjeti ka nje kohe te gjate qe nuk ka punuar.


Studiuam skemen hidraulike te mjetit. Grupi shperndares ishte i tipit Danfoss PVG 32 dhe sistemi ishte i tipit "Load Sensing". Matem presionin e "load sensing" dhe vume re qe kur mjeti ishte i ndezur dhe nuk aktivizohesh asnje komande, presioni ishte shume i larte. Kjo tregonte qe diku ne sistem njera nga valvolat qendronte e aktivizuar edhe pse operatori nuk i prekte fare komandat. I kontrolloam valvolat nje e nga nje dhe ne perfundim identifikuam njeren prej tyre me "defekt". Ne fakt valvola nuk ishte me defekt, valvola ishte blere gabim. Çmimi i valvoles rreth 800 euro. Me tej kuptojeni vete.

VALVOLAT SANWITCH ME FLLANXHA SAE

VALVOLAT E SHFRYRJES SE PRESIONIT, SANWITCH ME FLLANXHA SAE.....HK REM

Cilësitë	
Dizenjo	Me flanaxhë SAE
Furnizohet	Së bashku me flanaxhën SAE dhe me bulonat M10
Presioni maksimal	max. 250 bar

Përshkrim	
Valvol shfryrëse (kufizuese) e presionit e komanduar me pilotim	
Versioni me valvol shfryrëse presioni me selenoid për qarkullimin e lirë të vajit nga pompat, është HK REM 24	
Prurja maksimale = 600 l/min	
E përshtatshme për vaj hidraulik me bazë minerare dhe për vajin sintetik	




Kodi	Lidhjet	Presioni maksimal që mund të rregjistrohet (Bar)	Presioni maksimal që mund të rregjistrohet (Bar)	Prurja maksimale (l/min)	Pesha (kg)
HK REM 3 350	Fllanxhë SAE 3/4"	350	8	200.0	6.600
HK REM 4 210	Fllanxhë SAE 1"	210	7	400.0	6.800
HK REM 5 210	Fllanxhë SAE 1.1/4"	210	7	600.0	8.200

HANSA FLEX

VALVOLAT E SHFRYRJES SE PRESIONIT, SANWITCH ME FLLANXHA SAE.....HK REM 24

Cilësitë	
Dizenjo	Me flanaxhë SAE dhe valvol shfryrëse me selenoid 24 VDC
Furnizohet	Së bashku me flanaxhën SAE dhe me bulonat M10
Presioni maksimal	max. 250 bar

Përshkrim	
Valvol shfryrëse (kufizuese) e presionit e komanduar me pilotim	
Me dy mundësi të regjistrimit të vlerave të presionit	
Prurja maksimale = 600 l/min	
E përshtatshme për vaj hidraulik me bazë minerare dhe për vajin sintetik	



Kodi	Lidhjet	Presioni maksimal që mund të rregjistrohet (Bar)	Presioni maksimal që mund të rregjistrohet (Bar)	Prurja maksimale (l/min)	Pesha (kg)
HK REM 3 20 350 350 24	Fllanxhë SAE 3/4"	350	8	200.0	9.200
HK REM 4 20 210 210 24	Fllanxhë SAE 1"	210	7	400.0	9.200
HK REM 5 20 210 210 24	Fllanxhë SAE 1.1/4"	210	7	600.0	9.200

HANSA FLEX